REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-400/01-0035693/25
Data.
Data. 22. 08. 2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**<u>Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Ofice of the Mayor</u>**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 dhe 16 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.01-400/01-0051689/20 të datës 04.12.2020, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës Nr. 02-400/01-0035693/25, të datës 19.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M
**(Për lejimin e mjeteve financiare)**

**I.** **Lejohen** mjetet financiare, në shumë prej **800 Euro,** për z. [redacted] për mbështetje financiare për trajtim mjekësor dhe shërim të vëllaut të tij z. Xhavit Alija, sipas dokumentacionit mjekësor bashkangjitur këtij vendimi.

**II.** Mjetet e lartcekura do të paguhen nga kategoria e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

**III.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DBF-së
- Palës

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA SKENDERAJ
Nr./No. 02-020/01-0032399/25
Data/Data 06.08.2025


**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj


**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së menaxherit të kontratës nr.06-343/01-0031709/25, të datës 04.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## MBI EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT

I. **Formohet** komisioni për riformatim të paramasës në projektin **"Ndërtimi i Rrugës Kozhicë - Qyqavicë"**, në këtë përbërje:

1. **Sanije Ahmeti,** kryesuese
2. **Valentina Aliu,** anëtare
3. **Rifat Bajraktari,** anëtar

II. **Detyrë e Komisionit** është që të bëjë shqyrtimin dhe riformatimin e pozicioneve konform gjendjes në terren dhe pozicioneve të kontraktuara në projektin e cekur në pikën **I** të këtij vendimi, sipas kërkesës nga menaxheri i projektit i.d.n Visar Hyseni.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur: Kërkesa nr. 06-343/01-0031709/25, dt. 04.09.2023, si dhe paramasa dhe parallogaria.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DUMA-së
- DPP-së
- Anëtarëve të Komisionit

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0037269/24
Data.
Data. 26-08-2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të dt 03.12.2008, pas shqyrtimit të propozimit përmes email-it të datës 21.08.2025, nga z.Fatmir Balaj Koordinator për Kthim, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **Formohet** komisioni komunal për Ri-integrim, në këtë përbërje:

   **1.1 Shahin Tahiri**, Drejtor i DSHMS-së, përfaqësues për shëndetësi;
   **1.2 Ragip Ymeri**, përfaqësues nga Drejtoria për Arsim;
   **1.3 Ylli Veliqi**, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale;
   **1.4 Milaim Ramadani,** përfaqësues për Punë e Punësim;
   **1.5 Sokol Hoxha,** përfaqësues nga Shërbimet Publike;
   **1.6 Hetem Dajaku,** përfaqësues për Planifikim, Urbanizëm e Çështje Banimi;
   **1.7 Besmir Baliu,** përfaqësues për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
   **1.8 Fatmir Balaj,** përfaqësues nga ZKK;
   **1.9 Mirsad Gashi,** përfaqësues për Integrime Evropiane;
   **1.10.Besnik Zabelaj,** përfaqësues për të Drejtat e Njeriut.

2. **Detyrë e komisionit të lartcekur** është të bëjë shqyrtimin dhe vendosjen rreth kërkesave të personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegrimit, si në vijim: Akomodim me qira, asistencë mjekësore, rindërtim ose renovim të shtëpive, pako të orendive shtëpiake. KKR shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar në harmoni me rregulloren nr.22/2020 dhe me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

3. Komisioni obligohet që për punën e tij, t'i raportoj me shkrim Kryetarit të Komunës.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi në bazë të dispozitave të nenit 53, nenit 57 pika 1, nenit 58 pika 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, **shfuqizohet** vendimi nr.02-020/01-0001801/22 të datës 12.01.2022, dhe të gjitha plotësim ndryshimet si rrjedhojë e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendim i'u dërgohet:**
- Arkivit
- Anëtarëve të komisionit

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E SKENDERAJT KRYETARI I KOMUNËS REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA SKENDERAJ PREDSEDNIK OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0037263/21
Data.
Data. 26 08 2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të dt 03.12.2008, pas shqyrtimit të propozimit përmes email-it të datës 21.08.2025, nga z.Fatmir Balaj Koordinator për Kthim, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. **Formohet** komisioni komunal për kthim, në këtë përbërje:

   **1.1 Nedelko Kovaçeviq** - ZKKK, kryesues
   **1.2 Ragip Ymeri** - DKA, anëtar
   **1.3 Shehrije Rama** – DSHMS, anëtare
   **1.4 Ylli Veliqi** – QPS, anëtar
   **1.5 Sokol Hoxha** – DSHP, anëtar
   **1.6 Hetem Dajaku** – DUMA, anëtar
   **1.7 Faik Syla,** - DGJKP, anëtar
   **1.8 Imer Llugiqi** - MKK, anëtar

2. Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në Komisionin Komunal për kthim nga radhët e donatorit rregullohet me marrëveshje në mes MKK-së, Komunës dhe donatorit.

3. UNHCR –ja ka rolin këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.

4. Komisioni Komunal për Kthim duhet të reflektoj përbërje etnike dhe gjinore, si dhe do të jetë i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllim të monitorimit.

5. Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues, i cili propozon rastet për vendim tek komisioni Qendror Shqyrtues në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi në bazë të dispozitave të nenit 53, nenit 57 pika 1, nenit 58 pika 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, **shfuqizohet** vendimi nr.02-020/01-0019155/22 të datës 29.04.2022, dhe të gjitha plotësim ndryshimet si rrjedhojë e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dërgohet:**

- Arkivit
- Anëtarëve të Komisionit

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SKENDERAJT
KRYETARI I KOMUNËS
REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA SKENDERAJ
PREDSEDNIK OPŠTINE
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0037276/25
No.
Data 25.08.2025
Data

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, dt. 03.12.2008, si dhe Propozimin e DShMS-së nr.08-020/01-0036608/25, të datës 21.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

I. **Formohet** Njësiti për Implementimin e Projektit "Ndërtimi i Njësive të Reja të Banimit Social", në këtë përbërje:

1. **Albinot Mehmeti,** Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - kryesues;
2. **Armend Musliu,** Koordinator për Banim Social - anëtar;
3. **Besart Geci,** Analist i Buxhetit – anëtar;
4. **Sanije Ahmeti,** Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit – anëtare.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësitit përfshijnë: Kompletimin e dosjes së aplikimit për projektin, raportimin periodik dhe përfundimtar sipas kërkesave të donatorëve dhe institucioneve përkatëse, mbikëqyrjen e aktiviteteve të projektit në të gjitha fazat dhe menaxhimin e përgjithshëm të projektit deri në përfundimin e tij.

III. Anëtarët e Njësitit kompensohen me 20 % të pagës bazë, për çdo muaj përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, i cili planifikohet të zgjatë tre (3) vite.

IV. Obligohen **DShMS** dhe **NjMBNj** për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DShMS-së
- NjMBNj-së
- Anëtarëve

**Kryetari i Komunës**

**Fadil Nura**

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 59 pika 1 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, nenit 39 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së DPP-së Nr.14-020/01-0031292/25 të datës 01.08.2025, dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

**(Mbi caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave)**

I. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e tenderit me titull: **"006 – Furnizimi me barna dhe material shpenzues për QKMF në Skenderaj"**, me nr.Prokurimi: 643-25-6072-1-3-6, në këtë përbërje:

1. **Albinot Mehmeti**, kryesues
2. **Bujar Goxhuli,** anëtar
3. **Armend Musliu,** anëtar

II. Komisioni i lartcekur ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për tenderin sipas pikës I të këtij vendimi konform dispozitave ligjore në fuqi për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DPP-së
- Anëtarëve të komisionit

**Kryetari i Komunës**

**Bekim Jashari**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E SKENDERAJ – REPUBLIKA KOSOVA – OPŠTINA SKENDERAJ – PREDSEDNIK OPŠTINE – MUNICIPALITY OF SKENDERAJ – REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-111/01-0035837/25
Data.
Data. 19.08.2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294, sipas kërkesës së DGJKP-së nr.05-111/01-0030228/25, të dt. 28.07.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**I.** **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të konkursit për plotësimin e pozitës:

- **Asistent Administrativ në DGJKP – një (1) pozitë**

**II.** **Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore** të bëjë zhvillimin e procedurave nga pika **I**, konform legjislacionit në fuqi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- NJMBNJ-së
- DGJKP-së

**Kryetari i Komunës**

**Fadil Nura**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • KRYETARI I KOMUNËS • REPUBLIKA KOSOVA • OPŠTINA SKENDERAJ • PREDSEDNIK OPŠTINE • REPUBLIC OF KOSOVA • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-111/01-0035846/25
Data.
Data. 19. 08. 2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

<u>**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor</u>

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294, sipas kërkesës së NJMBNJ-së nr.02-111/01-0035752/25, të dt. 19.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**I.** **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të konkursit për plotësimin e pozitës:

- **Zyrtar Administrativ – një (1) pozitë**

**II.** **Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore** të bëjë zhvillimin e procedurave nga pika **I**, konform legjislacionit në fuqi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- NJMBNJ-së

**Kryetari i Komunës**

**Fadil Nura**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • KRYETARI I KOMUNËS • REPUBLIKA KOSOVA • OPŠTINA SKENDERAJ • PREDSEDNIK OPŠTINE • MUNICIPALITY

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr./No. 02-111/01-0036860/25
Data/Data 22.08.2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

<u>**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor</u>

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294, sipas kërkesës së NJMBNJ-së nr.10-111/01-0036297/25, të dt. 20.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

**I.** **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të konkursit për plotësimin e pozitës:

- **Zyrtar për Bujqësi – një (1) pozitë**

**II.** **Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore** të bëjë zhvillimin e procedurave nga pika **I**, konform legjislacionit në fuqi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet**:
- Arkivit
- NJMBNJ-së

**Kryetari i Komunës**

**Fadil Nura**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SKENDERAJT • KRYETARI I KOMUNËS • OPŠTINA SKENDERAJ • PREDSEDNIK OPŠTINE • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA
SKENDERAJ
Nr./No. 02-020/01-0032094/25
Data/Data 05-08-2025

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, konform nenit 70 paragrafi 70.18 dhe 70.19 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, sipas kërkesës së DPP-së Nr.14-020/01-0031290/25 të datës 31.07.2025, dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

**I.** Me këtë vendim caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit/kontratës për tenderin me titull: **"035 – Organizimi i panairit për gratë ndërmarrëse si dhe akterëve tjerë të rëndësishëm"**, me nr. Prokurimi: 643-25-5731-1-3-6

1. **Baki Beqiri, caktohet** menaxher i kontratës sipas pikës **I** të këtij vendimi.

2. **Mirlinda Dërguti, caktohet** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës **I** të këtij vendimi.

**II.** Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 70 paragrafi 70.17, 70.23, 70.24 dhe 70.25 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, të Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DPP-së
- Menaxherit
- Mbikëqyrësit

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E SKENDERAJT · KRYETARI I KOMUNËS · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA SKENDERAJ · PREDSEDNIK OPŠTINE · REPUBLIC OF KOSOVA · MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së DUMA-së Nr.06-020/01-0037489/25 të datës 26.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**I.** **z.Visar Hyseni caktohet** zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Marrëveshjes së Zhvillimit Nr.02/400/01-0028224/25 të datës 15.07.2025, lidhur me projektet si në vijim: **"Ndërtimi i urës në rrugën Ilaz Kodra", "Punimi dhe vendosja e paneleve ndriquese në vendkalimin e këmbësorve-rrugëve në qytet" dhe "Realizimi i shtatores së Beqir dhe Rexhep Rexhepi"** në Skenderaj.

**II.** **Detyrë** e të lartcekurit është që në mënyrë objektive dhe profesionale të mbikëqyrë zbatimin e marrëveshjes së zhvillimit lidhur me projektet e cekura në pikën I të këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dërgohet:**
- Arkivit
- DUMA-së
- z.Visar Hyseni

**Kryetari i Komunës**

Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-370/01-0036886/25
Data.
Data. 22. 08. 2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 46 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, konform nenit 45 paragrafi 45.6 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, sipas nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, dhe sipas kërkesës së DSHP-së Nr. 09-370/01-0036590/25, të datës 21.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**(Mbi zbatimin e përdorimit të afateve të përshpejtuara kohore)**

**I.** **LEJOHET** zbatimi i përdorimit të afateve të përshpejtuara kohore për procedurën e tenderimit për projektin me titull: **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve ne territorin e Komunës së Skenderajt gjatë sezonit dimëror"**.

**II.** **Obligohet** Drejtoria e Prokurimit Publik që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të zbatoj përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore për procedurën e tenderimit për projektin sipas pikës I të këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DSHP-së
- DPP-së

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E SKENDERAJT KRYETARI I KOMUNËS REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA SKENDERAJ PREDSEDNIK OPŠTINE REPUBLIC OF KOSOVO MUNICIPALITY OF SKENDERAJ MAYOR

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA
SKENDERAJ
Nr. 02-370/01-0031/03/21
Data 05.08.2021

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DSHP-së Nr.09-370/01-0030974/25, të datës 30.07.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**MBI LEJIMIN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS**

**I. Lejohet** zhvillimi i procedurave të tenderimit për projektin: **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në territorin e Komunës së Skenderajt gjatë sezonit dimëror".**

**II. Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëj zhvillimin e procedurave të tenderimit për projektin sipas pikës I të këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DSHP-së
- DPP-së

**Kryetari i Komunës**
Bedri Hamza

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E SKENDERAJ / KRYETARI I KOMUNËS / REPUBLIKA KOSOVA / OPŠTINA SKENDERAJ / PREDSEDNIK OPŠTINE / REPUBLIC OF KOSOVO / MUNICIPALITY OF SKENDERAJ / MAYOR

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-370/01-0036905/25
Data.
Data. 22.08.2025

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, sipas kërkesës së DZHENIT Nr.12-351/01-0036727/25 të datës 22.08.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**(Mbi lejimin e zhvillimit të procedurës)**

**I.** **LEJOHET** zhvillimi i procedurave të tenderimit për projektin: **"Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku "Idriz Rreci"**.

**II.** **Obligohet Drejtoria e Prokurimit Publik** që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë zhvillimin e procedurave të tenderimit për projektin sipas pikës I të këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- DZHENIT
- DPP-së

**Kryetari i Komunës**
Fadil Nura